

**MËSIMDHËNIA ME NË QENDËR NXËNSIN NË ARËSIMIN FILLOR....**  
**PËRVOJË E PROBLEMATIKË NGA CIKLI FILLOR I SHKOLLAVE 9-**  
**VJEÇARE NË KORÇË DHE ELBASAN**

**Xhevdet Zekaj<sup>1</sup> Eriselda Vrapit<sup>2</sup> Gloria Haxhiaj<sup>3</sup>**

<sup>1</sup> Lektor në Universitetin “A.Xhuvani”, Elbasan

<sup>2</sup> Shkola 9-vjeçare Papër Elbasan

<sup>3</sup> Gloria Haxhiaj, Korçë

**Abstrakt**

Mësimdhënia me në qendër fëmijën, në shkollën fillore, inkurajon praktika të përshtatshme zhvillimore, që mbajnë parasysh fëmijën në tërësi. Trajtimi i mësimdhënies me në qendër fëmijën bazohet në individualizimin përmes veprimtarive në qendrat e aktivitetit. Në mësimdhënien me në qendër fëmijën përfitojnë të gjithë: pjesëmarrja aktive e prindërve në veprimtaritë mësimore –edukative të organizuara në klasë, mësuesit nxiten nga përmbajtja dhe mundësitë e reja të përdorin metoda të reja mësimore, fëmijët cilësohen si mendimtarë të aftë dhe origjinalë, të aftë të fitojnë shprehje akademike, artistike, etike dhe praktike në mënyrë që të marrin pjesë në shoqërinë demokratike me sukses. Përmes këtij studimi synohet që të shihet mësimdhënia me në qendër nxënësin si një domosdoshmëri në krijimin e brezit të ri të aftë për të përballuar sfidat e jetës në një shoqëri demokratike, por edhe parë në raport me ndryshimet që duhet të pësojë në sfidat me të cilat ballafaqohet arsimit sot. Në ciklin fillor të praktikohet integrimi ndërlëndor për të shmangur ngarkesën e fëmijëve dhe marrjen e njohurive të shkëputura nga realiteti i tyre. Gjithashtu të futet në kurrikulën për përgatitjen e studentëve të ciklit fillor lëndë që aftësojnë studentët për përdorimin e metodave me në qendër nxënësin dhe integrimin ndërlëndor.

**Fjalë kyçe:** *të mësuarit përmes lojës, stilet e të nxënës, integrimi ndërlëndor, puna me tema, pyetje të hapura, produkt dhe proces, qendra të aktivitetit.*

---

<sup>1</sup> Lektor në Universitetin “A.Xhuvani”, Elbasan

<sup>2</sup> Shkola 9vjeçare Papër Elbasan

<sup>3</sup> Gloria Haxhiaj, Korçë